

ZYRA E PROKURIMIT

NR 312-42449/22
DATE 22.12.2022

KONTRATË NR.107-2022

Numri i kontratës ¹: 634-22-12265-1-2-1/C542

KUVENDI KOMUNAL I KLINËS, (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njërën anë; dhe
" I.P.N.EU " SH.P.K., ASLLAN PIREVA 551, PRISHTINË, (në vazhdim "Furnizuesi"), në anën tjetër, janë
pajtuar të lidhin një kontratë publike për furnizimet e shënuara me poshtë:

**Furnizim me gjenerator dhe servisim Lot.1- furnizim me gjenerator. Lot. 2- servisim i gjeneratorve dhe
Lot-3 Furnizim me antifriz me numër identifikues: 634-22-12265-1-2-1**

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës do të jetë nga Furnizuesi, i furnizimeve në vijim:

Nr.	Grupi
2	Furnizim me gjenerator dhe servisim lot. 2- servisim i gjeneratorve

Neni 2 Kushtet e dërgesës

2.1 Afati kohor për dorëzim do të jetë 10 ditë nga koha e lëshimit të urdhër blerjes nga ana e Autoritetit Kontraktues.

2.2 Vendi i dorëzimit të furnizimit do të jetë **ne kline dhe shkollat e klinae**.

2.3 Inkotermi² i zbatueshëm do të jetë **DDP Kline**.

¹ Ju lutemi referojuni këtij numri të kontratës në dokumentet e faturimit dhe pagesës, procedurat dhe transaksionet që lidhen me thesarin.

² Incoterms 2010 Oda Ekonomike Ndërkombëtare

Neni 3 Origjina

3.1 Furnizuesi duhet të dorëzojë një certifikatë të origjinës së furnizimeve, më së voni atëherë kur e kërkon pranimin e përkohshëm të furnizimeve. Mosveprimi sipas këtij kushti mund të ketë si rezultat ndërprerjen e kontratës.

3.2 Origjina e mallrave do të përcaktohet sipas Kodit të Doganave të Bashkësisë Evropiane (Community Customs Code-) ose sipas marrëveshjeve ndërkombëtare të cilat i ka nënshkruar vendi në fjalë.

Neni 4 Çmimi

4.1 Çmimi total i furnizimeve duhet të jetë: 1,500.00 €; njëmijë e pseqind Euro.

4.2 Çmimi i përmendur në Nenin 4.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Furnizuesit sipas kontratës.

4.3 Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve.

4.4 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e përgjithshme dhe/ose të Veçanta të kontratës.

Neni 5 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës

5.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- (a) Kjo marrëveshje e kontratës;
- (b) Kushtet e Veçanta të Kontratës;
- (c) Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
- (d) Tenderi i Furnizuesit, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike;
- (e) Oferta financiare;

5.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

Neni 6 Komunikimet

6.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Furnizuesit nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht.

6.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimin të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimin të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

6.3 Kudo që në kontratë parashikohet dhënia e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftimin e tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njoftoj", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të shenohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendimi i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.



REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIC OF KOSOVO

www.komuna-klinea.org

KOMUNA E KLINES
MUNICIPALITY OF KLINEA
OPSTINA KLINEA



PARAMASA: FURNIZIM ME GJENERATOR, SEVISIMI I GJENERATORËVE DHE FURNIZIM ME ANTI-FRIZ PËR NENJET QENDRORE


LOT.2 SERVISIMI I GJENERATORËVE

Nr.	Emërtimi i Materialit	Sasia	Çmimi	Gjithsej
1	SHFMU "Tre Dëshmorët" në Jashanicë, FURNIZIM, montim i baterisë (15A.9) për Gjeneratorin e markës SHARK DG 6500 LDE/3. Në çmim të përfshihet edhe demolimi i baterisë ekzistuese si dhe testimi i punës së gjeneratorit.	1	250	250
2	SHFMU "Tre Dëshmorët" në Gjurgjevik i Madh, FURNIZIM, montim me litarin për ndezje të Gjeneratorit të markës ASTRA KOREA. Në çmim të përfshihet edhe pastrimi i gjeneratorit dhe testimi i punës së gjeneratorit.	1	250	250
4	SHFMU "Atë Shtjefën Gjergov" në Zllakuqan, FURNIZIM, montim i baterisë për Gjeneratorin e markës LOMBARDINI DIESEL ENGINE 230/380V 50HZ. Në çmim të përfshihet edhe demolimi i baterisë ekzistuese si dhe testimi i punës së gjeneratorit.	1	250	250
5	SHFMU "Xhafer Gashi" në Përgjevë, FURNIZIM, montim i baterisë për Gjeneratorin e markës SHARK 220/380VA, ndërrimi i dinamos-aletrantorit (ruk e mubush baterinë vetem e harqjon), ndërrimi i rotave lëvizëse. Në çmim të përfshihet edhe demolimi i pjesëve që ndërrohen si dhe testimi i punës së gjeneratorit.	1	250	250
7	SHFMU "Atë Gjergj Fisha" në Jagodë, FURNIZIM, montim i baterisë për Inverter 2000 VA. Në çmim të përfshihet edhe demolimi i baterisë ekzistuese si dhe testimi i punës së inverterit.	1	250	250
8	SHFMU "Esad Mekuli" në Caravik, FURNIZIM, montim i baterisë për Inverter P=2000 VA; U=24V; F=50HZ; Ud=220V (+5-10)%, Në çmim të përfshihet edhe demolimi i baterisë ekzistuese si dhe testimi i punës së inverterit.	1	250	250
TOTALI			250	1500



Muharrem
"P.NEU" SH.PK
"Pristinë"

6.4 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën shqipe ³ në tri origjinale, dy prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Furnizuesin.

Për Autoritetin Kontraktues

Emri:	LABIHOT MORONA
Pozita:	Zyrtar përgjegjës i prokurimit
Nënshkrimi:	
Data:	22.12.2022
Vula:	

Për Furnizuesin

Emri:	ALI MUSHICA
Pozita:	DREJTOR
Nënshkrimi:	
Data:	22.12.2022
Vula:	

³ Gjuha do të jetë gjuha e shfrytëzuar nga tenderuesit në këtë tender.